



REPUBLICA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

| | | |
|---|--------------|---------------------|
| Pranuar / Dorezuar Prinjenj / Prilato Received / Delivery | 17. 12. 2020 | viti god year |
| Organ / Njësia Org / Jedinica Org / Unit | SKP/HR/CV | |
| Hi Prot Hi Prot Prot No | 3191/2020 | |
| Shtojta e Prilog Appendix | | |
| Sasia Kolicina Quantity | | 1/6 |



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.308/2020

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani-anëtarë, dhe Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.308/2020 të datës 19.10.2020 të parashtruar nga ankuesi [REDACTED] me adresë Rr. "Rasim Këçina" Komuna-Skenderaj, kundër Vendimit me numër reference: 210/2020 të datës 16.10.2020 të Kryeministrit të Republikës së Kosovës, në çështjen juridike "Ndërprerje e marrëdhënies së punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjen e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, të mbajtur me datë 17.12.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET si e bazuar ankesa me numër A.nr.308/2020 e datës 19.10.2020 e parashtruar nga ankuesi, [REDACTED]

II. ANULOHET Vendimi me numër reference 210/2020 i datës 16.10.2020 i Kryeministrit të Republikës së Kosovës.

III. OBLIGOHET Kryeministri i Republikës së Kosovës, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, duke e kthyer ankuesin [REDACTED] në pozitën e Drejtorit të Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës, sipas Vendimit me Nr.prot:2230/2019 të datës 05.02.2019, me të gjitha të drejtat dhe detyrimet nga marrëdhënia e punës, dhe të bëjë kompensimin e pagës nga dita e ndërprerjes së marrëdhënies së punës deri në zbatimin e këtij vendimi.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.



Arsyetim

Ankuesi, [REDACTED] përmes Vendimit me numër reference 210/2020 të datës 16.10.2020 të Kryeministrit të Republikës së Kosovës, me datë 16.10.2020 është liruar nga pozita e Drejtorit të Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës.

Kundër Vendimit me numër reference 210/2020 të datës 16.10.2020, ankuesi, brenda afatit ligjor, me datë 19.10.2020 ka parashtruar ankesën me numër protokoll 2146/2020, të regjistruar me numër A.nr.308/2020 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjen e Ankesave, më datë 23.10.2020, ka kërkuar përgjigje në ankesën e ankuesit nga Administrata Tatimore e Kosovës, ndërsa me datë 28.10.2020 ka dërguar kërkesë për përgjigje në ankesë tek Zyra e Kryeministrit dhe Ministria e Financave. Administrata Tatimore e Kosovës, me datë 29.10.2020, ndërsa Ministria e Financave më datë 10.11.2020 kanë përcjell përgjigjen në ankesë bashkë me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kryetari i Këshillit, bazuar në nenin 17 paragrafi 2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 27.11.2020 me kërkesë të Kryetarit të Kolegjit, ka nxjerr Vendimin VK.nr.19/2020 për zgjatjen e afatit për vendosjen e ankesës të ankuesit edhe për 10 ditë pune.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën e datës 19.10.2020 me numër protokoll 2146/2020 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër reference: 210/2020 të datës 16.10.2020 të Kryeministrit të Republikës së Kosovës; Vendimin me Nr.prot:2230/2019 të datës 05.02.2019 të Kryeministrit të Republikës së Kosovës; Shkresën e datës 03.09.2020 lidhur me zhvillimet gjatë vitit 2019 rreth ngritjes së Strukturës Organizative në ATK dhe sfidat gjatë zbatimit të saj, të ankuesit për Ministren e Ministrisë së Financave; Struktura e Përgjithshme Organizative të Administratës Tatimore të Kosovës, të datës 10.05.2019; Pëlqimin e datës 12.05.2014 nga Ministria e Administratës Publike; E-mailin e datës 24.06.2016 nga [REDACTED] për [REDACTED] dhe [REDACTED]; E-mailin e datës 16.05.2019 nga ankuesi për [REDACTED] E-mailin e datës 16.05.2019 nga [REDACTED] për ankuesin; E-mailin e datës 02.09.2020 nga ankuesi për Ministren Hykmete Bajrami; E-mailin e datës 27.02.2020 nga ankuesi për Ministrin [REDACTED]; E-mailin e datës 26.02.2020 nga [REDACTED] për [REDACTED] E-mailin e datës 27.02.2020 nga [REDACTED] për [REDACTED]; Dokumentin nga Komisioni Evropian të datës 10.06.2020; Draft raportin teknik, janar 2020; Akt Emërimit të datës 25.03.2014; Konkursin e Brendshëm të datës 05.06.2019; Njoftim për anulimin e konkursit të datës 19.06.2019; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 23.10.2020 për Administratën Tatimore të Kosovës; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 28.10.2020 për Zyrën e Kryeministrit dhe Ministrinë e Financave; Njoftimin e datës 03.11.2020 nga Zyra e Kryeministrit dhe Ministria e Financave për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Njoftim e datës 10.09.2019 për ATK nga Ministria e Administratës Publike; E-mailin e datës 10.06.2019 nga [REDACTED]; E-mailin e datës 07.05.2019 nga [REDACTED] për [REDACTED]; E-mailin e datës 29.10.2020, 11.06.2019 dhe 12.06.2019 nga [REDACTED] për [REDACTED] E-mailin e datës 07.05.2019 nga [REDACTED] për [REDACTED]

██████████ E-mailin e datës 17.05.2019 nga ██████████-██████████ E-mailin e datës 10.06.2019 nga ██████████; Projekt Rregullore Nr. ATK 13/2019 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Administratën Tatimore të Kosovës, të datës 17.05.2019; Shkresën përcjellëse lidhur me Projekt Rregulloren mbi organizimin e Brendshëm në Administratën Tatimore, të datës 29.06.2016; E-mailin e datës 24.06.2016 nga ██████████; Vendimin mbi Strukturën Organizative të Administratës Tatimore të Kosovës, të datës 15.03.2016; Shkresë njoftuese lidhur me suprimimin e pozitive të punës si rezultat i riorganizimit të Administratës Tatimore, nga ankuesi të datë 14.05.2019; E-mailin e datës 05.06.2019 nga ██████████ për ankuesin dhe të tjerët; Konkursi i Brendshëm i datës 05.06.2019 i shpallur nga Administrata Tatimore e Kosovës; Akt Emërimit të datës 28.02.2014 të Nahit Sharku; Njoftim për anulimin e konkursit, të datës 19.06.2019, nga Administrata Tatimore e Kosovës; Vendimin me Nr. prot:127 të datës 18.06.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Administratës Tatimore të Kosovës; Vendimin e datës 13.06.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës; Vendimin me Nr. port:330 të datës 13.06.2019 nga Drejtori i Përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës; Vendimin me Nr. prot:153 të datës 24.07.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Administratës Tatimore të Kosovës; Vendimin me Nr. prot:333 të datës 13.06.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës; Vendimin me Nr. prot:334 të datës 13.06.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës; Ankesën e ██████████ për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-mailin e datës 02.08.2019 dhe 08.08.2019 nga ██████████; E-mailin e datës 31.01.2019 nga ██████████; E-mailin e datës 19.07.2019 nga ██████████; E-mailin e datës 23.05.2019 nga ██████████, Konkursin e Brendshëm të datës 17.09.2019 të shpallur nga Administrata Tatimore e Kosovës; E-mailin e datës 11.09.2019 nga ██████████ Konkursin e Jashtëm të datës 22.03.2019 të shpallur nga Administrata Tatimore e Kosovës; E-mailin e datës 16.09.2019 nga ██████████; E-mailin e datës 16.09.2019, 17.09.2019 nga ██████████; Njoftim për Pezullim të Konkurseve të Publikuara më datë 12, 13 dhe 16 Shtator 2016; Shkresën nga ██████████ të datës 12.09.2020; Mendim Juridik të Avokatit të Popullit të Republikës së Kosovës në cilësinë e Mikut të Gjykatës, drejtuar Gjykatës Themelore në Prishtinë me datë 09.07.2020.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështjeje ka shqyrtuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, dhe ka konstatuar se ankesa e ankuesit është e bazuar, sepse:

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, bazuar në shkresat e lëndës ka konstatuar se ankuesi, me datë 05.02.2019, përmes Vendimit me Nr. prot:2230/2019 të Kryeministrit të Republikës së Kosovës, është emëruar Drejtor i Përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës, me mandat 3 vjeçar, me mundësi vazhdimi. Emërimi i ankuesit në pozitën e Drejtorit të Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës, është bërë përmes procedurës së rekrutimit të zhvilluar sipas legjislacionit të aplikueshëm për Shërbimin Civil të Kosovës, ashtu siç ka qenë e përcaktuar me nenin 3 paragrafi 1 të Ligjit Nr.03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat.

Kryeministri i Republikës së Kosovës, me datë 16.10.2020, përmes Vendimit me numër reference 210/2020 ka liruar ankuesin nga pozita e Drejtorit të Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës, për shkak të pa aftësisë dhe sjelljes së keqe, nën supozimin se ka miratuar rregulloren për organizimin e brendshëm të ATK-se në kundërshtim me Ligjin Nr.06/L-113 për Organizimin

dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, pa marr pëlqim paraprak të Ministria përkatëse dhe pa e proceduar të Kryeministri për aprovim; Ka shpallur konkurs për pozita të lira pune, 3 pozita të zëvendës drejtorit të përgjithshëm, ku ka emëruar ushtrues detyre dhe nuk ka sistemuar ish zëvendës drejtorët, të cilët i ka konsideruar tepricë; Ka bërë lëvizjen e shpeshhtë të stafit, nga pozita e tyre në pozita tjera dhe ka shkaktuar pakënaqësi të madhe duke degraduar zyrtarët e kësaj agjencie në pagat e tyre, me tutje në vendim ceket se këto shkelje janë të konfirmuara edhe në Mendimin Juridik të Avokatit të Popullit, me numër reference 1031/2020 të datës 09.07.2020, në cilësinë e Mikut të Gjykatës (Amicus Curiae).

Parashtruesi i ankesës pretendon se Vendimi me numër reference 210/2020 i datës 16.10.2020 për lirim të tij nga pozita e Drejtorit të Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës, është nxjerr në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, dispozitat e Ligjit Nr.03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, si dhe Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, gjatë shqyrtimit të pretendimeve ankimore, ka analizuar Aktgjykimin në rastin Nr.KO203/19 me numër reference AGJ 1583/20 të datës 09.07.2020 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, lidhur me vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, dhe ka gjetur se Gjykata Kushtetuese në pikën 211 të aktgjyimit ka konstatuar se: ... *Deri në plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë nga ana e Kuvendit, dispozitat e këtij Ligji zbatohen vetëm për atë që nuk cenon pavarësinë funksionale dhe organizative të Institucioneve të Pavarura të referuara specifikisht në dispozitiv të këtij Aktgjykimi. Ndërsa, në raport me të gjitha institucionet e tjera, Ligji nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë zbatohet nga hyrja në fuqi e këtij Aktgjykimi.* Andaj, si rrjedhojë, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se Ligji Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë është i zbatueshëm nga data 09.07.2020, dhe i njëjti, me dispozitat e neni 32 paragrafi 3 ka përcaktuar, se: *Themelimi, ndryshimi apo përfundimi i marrëdhënies së punës në Shërbimin Civil bëhet vetëm sipas këtij ligji,* ndërsa neni 85 ka shfuqizuar Ligji Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil dhe çdo dispozitë tjetër në kundërshtim me këtë ligj.

Po ashtu, duke u bazuar në nenin 9 paragrafin 2 nën paragrafin 2.2 dhe nenin 22 paragrafin 1 dhe 2 të Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, si dhe nenin 2 paragrafin 3, dhe nenin 33 paragrafin 2 nën paragrafin 2.1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se pozita e Drejtorit të Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës, hynë në kategorinë e pozitave të nivelit të lartë drejtues në kuadër të Shërbimit Civil, andaj, si rrjedhojë marrëdhënia e punës e ankuesit rregullohet me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Lidhur me pretendimet ankimore të ankuesit, se vendimi për lirim nga Pozita e Drejtorit të Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës, për shkak të paaftësisë dhe sjelljes së keqe, është nxjerr në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për Zyrtarët Publikë, Kolegji ka analizuar dispozitat e këtij ligji, dhe ka konstatuar se Ligji Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht neni 59, rregullon mënyrën e përfundimit të marrëdhënies së punës në Shërbimin Civil, duke përcaktuar se: *1. Marrëdhënia e punës në Shërbimin Civil, përfundon si ne vijim; 1.1. për shkaqet e përcaktuara në neni 60 të këtij ligji; 1.2. me lirim nga Shërbimi Civil sipas neneve 61 dhe 62 të këtij ligji; dhe 1.3. largimi nga Shërbimi Civil, si masë disiplinore në përputhje me këtë ligj.* Rrjedhimisht, Kolegji

ka analizuar edhe dispozitat e nenit 61 ku përcaktohet se: 1. Marrëdhënia e punës në Shërbimin Civil përfundon me lirim nga Shërbimi Civil, në këto raste: 1.1. për shkak të refuzimit të pajustificuar të nëpunësit për të pranuar transferimin, sipas neneve 53 dhe 54 të këtij ligji; 1.2. kur nëpunësi deklarohet i paaftë për punë nga komisioni kompetent mjekësor, sipas ligjit; 1.3. pas dy vlerësimeve "jo kënaqshëm", për dy vjet radhazi, të rezultateve në punë; 1.4. kur nëpunësi ushtron të drejtën për pensionim të parakohshëm, sipas këtij ligji; 1.5. kur nëpunësi civil gjendet në një situatë të konfliktit të vazhdueshëm të interesit, të deklaruar nga vetë nëpunësi dhe, sipas ligjit, nuk merr masat e parashikuara për shmangien e konfliktit të interesit brenda afatit të përcaktuar apo nëse transferimi në një pozitë tjetër nuk do të mënjanonte gjendjen e konfliktit të vazhdueshëm të interesit; 1.6. kur nëpunësi i kategorisë së lartë drejtuese anëtarësohet në një parti politike ose kur nëpunësit e niveleve të tjera bëhen anëtarë të organeve drejtuese të një partie politike; 1.7. në çdo rast tjetër, të parashikuar me ligj, dhe ka konstatuar se me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër reference 210/2020 të datës 16.10.2020, për lirim e ankuesit nga pozita e Drejtorit të Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës, nuk është përmbush asnjëri nga kushtet e përcaktuara në nenin 61 paragrafin 1 të Ligjit për Zyrtarët Publikë, dhe si i tillë vendimi për lirim e ankuesit nga detyra është në kundërshtim me dispozitat e nenit 61 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, kështu që pretendimi ankimor i ankuesit në këtë kuptim është i bazuar.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, konsideron se paaftësia profesionale e nëpunësit civil për ushtrimin e detyrave të punës përben shkak ligjor për përfundimin e marrëdhënies së punës, mirëpo vlerëson se paaftësia duhet të vërtetohet nga udhëheqësi i drejtpërdrejtë gjatë procesit të vlerësimit të rezultateve të punës, dhe nëse për dy vite radhazi nëpunësi civil merr vlerësim jo të kënaqshëm, atëherë përmbushet kushti ligjor për lirim nga Shërbimi Civil, ashtu siç përcaktohet me nenin 61 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë. Po ashtu, Kolegji konsideron se sjellja e keqe e nëpunësit civil gjatë ushtrimit të detyrave të punës përben shkak ligjor për përfundimin e marrëdhënies së punës, përkatësisht largimin nga Shërbimi Civil, siç përcaktohet me nenin 59 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, mirëpo Kolegji vlerëson se sjellja e keqe e nëpunësit civil duhet të vërtetohet nga organi kompetent, në këtë rast nga Këshilli Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë, konform dispozitave të nenit 45, 46, 47, 48, 49 dhe 50 të këtij ligji, dhe vetëm pas konstatimit të shkeljes e cila korespondon me masë disiplinore "largim nga shërbimi civil", konsiderohet se është përmbush kushti ligjor për largimin e nëpunësit civil nga Shërbimi Civil. Andaj, duke u bazuar në shkresat e lëndës, meqenëse është konstatuar se ankuesi nuk posedon dy vlerësime jo të kënaqshme për dy vite radhazi nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë, po ashtu ndaj ankuesit nuk është zhvilluar procedurë disiplinore, lidhur me shkeljet e pretenduara në vendimin e kontestuar, Kolegji vlerëson se nuk është përmbush kushti ligjor për lirim e ankuesit nga Pozita e Drejtorit të Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës, për shkak të paaftësisë dhe sjelljes së keqe, kështu që pretendimi ankimor i ankuesit në këtë kuptim është i bazuar.

Kolegji, po ashtu, duke u bazuar në nenin 61 paragrafin 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ka konstatuar se lirim nga Shërbimi Civil, deklarohet me vendim të Njesisë së Burimeve Njerëzore të institucionit, ku nëpunësi ushtron detyrën, ndërsa për nëpunësit civil të kategorisë së lartë drejtuese në institucionet e administratës shtetërore, lirim nga Shërbimi Civil, bëhet me vendim të Qeverisë, bazuar në propozimin e ministrit përgjegjës për administratën publike, andaj, Kolegji vlerëson se vendimi për lirim e ankuesit nga pozita e Drejtorit të Përgjithshëm të

Administratës Tatimore, është në kundërshtim me nenin 61 paragrafi 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Ndërsa, lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit se Vendimi me numër reference 210/2020 i datës 16.10.2020 është nxjerr në kundërshtim me dispozitat që rregullojnë formën dhe elementet e detyrueshme të aktit administrativ, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, duke marr parasysh se marrëdhënia e punës në Shërbimin Civil është marrëdhënie juridike e së drejtës administrative, ka shqyrtuar pretendimin ankimor dhe vlerëson se vendimi i kontestuar është në kundërshtim me nenin 47 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 dhe 1.4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, rrjedhimisht vendimi nuk përmban pjesën përmbyllëse apo këshillën ligjore lidhur me ushtrimin e mjeteve juridike, si element i detyrueshëm i aktit administrativ, po ashtu, vendimi nuk arsyeton gjendjen faktike dhe bazën juridike siç përcaktohet me nenin 48 paragrafin 2 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, kështu që pretendimi ankimor i ankuesit është i bazuar.

Andaj, pas konstatimit të shkeljeve procedurale, Kolegji për shqyrtimin e ankesave nuk është lëshuar në trajtimin e çështjeve tjera materiale, sepse vlerëson se Vendimi me numër reference 210/2020 i datës 16.10.2020 ka lëshime procedurale të tilla që nuk lejojnë trajtimin e tij.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, me shumicë të votave vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi. Anëtari i Kolegjit i cili ka dhënë mendim mospajtues me këtë vendim, duhet të jap me shkrim mendimin mospajtues dhe i njëjti duhet t'i bashkëngjitet dosjes së lëndës.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda me numër A.nr.308/2020

Avdyll BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet

- Ankuesit, [REDACTED]
- Kryeministrit të Republikës së Kosovës;
- Ministres së Ministrisë së Financave;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Administratën Tatimore të Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

